

Procesverbal

Nga seanca e X-të (dhjetë) e Kuvendit Komunal të Dragashit, e mbajtur më 31.10.2018, duke filluar në ora 10.00, me këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit, nga seanca e IX-të e Kuvendit...
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të reaktivimit të buxhetit, janar-shtator/2018,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Kërkesës-Pëlqimit të SH.P.K. "Sharr Pllanina Vode"-Dragash, për ndërtimin e mini-hidrocentraleve në ZK Brod, dhe
4. Eventuale...

Seancën, me përshëndetje të pranishmëve... e hapi kryesuesi i KK-së z.Betim Merdiu, me kërkesën dhe deklarin e delegatëve, nëse ka vërejtje apo plotësime të rendit të ditës, të dërguar me Ftesë...?

z.Munir Jonuzi- Në bazë të kompetencave ligjore që kam si kryesues i Kkomuniteteve, ju drejtohem se dje, në mbledhjen e këtij Komiteti, kemi marr qëndrimin, me shumicë votash, që pika e 3-të e rendit të ditës të heqet nga rendi i ditës, për shumë arsye, pasi se Kuvendi nuk ka kompetenca në kuadër të PN Sharri" për dhënien, apo mos dhënien e e tij e për pëlqime e koncesione ndërtimin e mini-hidrocentraleve në kuadër të Parkut në ZK Brod e në bazë të Kërkesës së z.Abidin Caro. Në bazë të Kërkesës dhe skicave të paraqitura shifet se parashtruesi ka për qëllim ndërtimin e mini-hidrocentraleve në kuadër të PN "Sharri" dhe atë në dy zona e që janë nën mbrojtje. Me diskutimin e kësaj pike të rendit të ditës, KK-ja drejtpërdrejtë, cenon Ligjin për PN "Sharri", Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, Planin Hapësinor, si dhe Rregulloren për Rending e Brendshëm të PN "Sharri", për këtë qëndrimi i Komitetit është, që kjo pikë e rendit të ditës, të hiqet nga rendi i ditës dhe mos të shqyrtohet dhe u propozoj delegatëve, që me votim, të heqet nga rendi i ditës?

z.Laurat Krasniqi- Pasi se ne (LV) nuk kemi përfaqësuesin tonë në komitete, që të heq kjo pikë e rendit të ditës-pa diskutime, nuk është e arsyeshme, edhe pse, në mandatin e kaluar, KK-ja ka dhënë pëlqime për parcela të caktuara dhe tani po e shqyrtojmë këtë Kërkesë dhe po vijmë në kundërshtim me etikën apo praktikën të cilën e keni zbatuar më herët. E di se hidro-centralet në Dragash janë problem dhe unë, personalisht, do të votoj kundër, por jam për diskutim reth mënyrës dhe formës, për të vepruar në periudhën e ardhëshme. Nëse nesër do të kemi operator të ri, faktikisht, kemi vepruar keqë. Nëse këtu ka interesa individuale nga kjo Kërkesë, kjo është diçka tjetër dhe, nëse ky Kuvend, deri tani, nuk i ka ndaluar ndërtimet e tyre, pse tani kjo pikë e rendit të ditës mos të shqyrtohet? Ne, si Kuvend, duhet të votojmë kundër kësaj Kërkesë, që populli të shfajtojë dhe, nëse nuk e përfshijmë në rend dite, apo nuk diskutojmë, e pengojmë dikënd që nesër mos të investon?

z.Zaim Hajredini- Kemi dy mendime, që të shqyrtohet e mos të votohet dhe mos të shqyrtohet fare. Në bazë të konsultimeve që kam pasur me ministrinë (MMPH) shifet se, në mas të madhe, ky investim është në kufijt e PN "Sharri", që krijon dyshime në atë që të japim apo jo Pëlqim? Jam i mendimit se, krahas kësaj Kërkesë, që të ketë edhe Pëlqimin e Ministrisë, se a kemi të drejtën apo jo që të investohet

në kuadër të PN “Sharri”. Ne, nëse e japim Pëlqimin, mendoj se MAPL-ja do të na këthen Vendimin tonë, pai se nuk kemi të drejtën të japim pëlqime në kuadër të PN “Sharri”.

z.Rexhep Kamberi- Dëshiroj të tërheq vërejtjen në 2 çështje e para ka qenë që të përcillet qëndrimi i komiteteve, që duhet të vlen edhe kësaj radhe dhe e dyta është se, të gjithë ne, jemi të vetëdijshëm se Projekti, përkatësisht mapat që na janë dërguar, të ishin ishin shënuar kufijt e PN “Sharri”. Me diskutimin e kësaj çështjeje, ne vetëm po humbim kohë dhe sido që të jetë epilogu, ne po e humbim kohën, nga se Ministria do të na këthen Vendimin tonë, si të kundërligjshëm. Mendoj se, në këtë rast, duhet të respektohet qëndrimi i KKomunitete, ku i kemi shqyrtuar detalisht të gjitha opcionet?

z.Laurat Krasniqi- Propozimet e mëhershme reth HC-ve kanë pasur prapavi politike dhe ky qytetar tani është banor i komunës sonë dhe nuk mund t’ia mohojmë të drejtën, kurse e drejta e çdo delegati është të voton “për” dhe “kundër” dhe se KKomuniteteve është i përbërë nga përfaqësues të ndryshëm të grupeve apo partive politike të cilat e përfaqësojnë popullin.

z.Zaim Hajredini- Ne, më herët, i kemi bërë të gjitha propozimet për ndërtimin e HC-ve, por që ato nuk kanë qenë në kuadër të kufijëve të PN “Sharri” dhe ky është rast specifik për të cilin e dijmë se nuk kemi të drejtën e dhënies së Pëlqimit?

z.Zinaida Elmazi- Pas vendosjes në KKomunitete, nuk shof kurrfar arsye që kjo pikë të jetë në rend dite dhe mos të na bini në situatë të majorizimit, duke e marr të drejtën e KKomunitete e që komuniteti shumicë të vendos vetë? Ju e dini fare mirë se kjo është e kundërligjshme e ne këtu jemi mbivotuar edhe lidhur me themelimin e PN “Sharri” dhe mos na detyroni në situatë, që të na bëni me dijeni se për ne nuk ka vend këtu, në këto hapësira?! Unë, edhe dje në KPFinanca, kam theksuar që të respektohet Ligji për Mbrojtjen e Natyrës 03-L/233-neni 11, Ligji për PN “Sharri”-neni 135 e 136 04-L/087, neni 349 i Ligjit Penal të Republikës së Kosovës dhe shiqoni ligjet e pastaj na sillni kërkesa të këtilla, për miratim apo jo?

z.Nexhat Isufi- Të gjitha diskutimet e deritashme, për mua, janë të rëndësishme dhe diskutimet nuk janë vendime por rekomandime e sidomos nëse vijnë nga komitetet, pasi se ata i propozojnë Kuvendit, ku miratohen vendime. Praktika ka qenë që se, kur kemi pasur rekomandime apo qëndrime të komiteteve, ne si Kuvend, i kemi marr parasysh ato dhe jam i mendimit se duhet të jap mendimin tim në Kuvend. Lidhur me dhënien e Pëlqimit unë jam për ate, deri në atë moment kur mos të cenohet ligji, dhe për këtë pse mos të shqyrtohen dhe sqarohen të gjitha pikat? Ky parashtues i Kërkesës është qytetari i ynë dhe gjithmonë kam kërkuar që zyrtari përkatës ligjor të jep sqarime, kur kemi paqartësi ligjore? Nëse kemi të drejtën të japim pëlqime në kuadër të oborrit tonë, këtë t’a bëjmë e për çështje tjera të sigurohen pëlqime nga ata që janë kompetent.

z.Granit Rifaj- Po theksoj se ne tash, më filluam debatin reth kësaj çështjeje-pike të rendit të ditës, dhe nëse është ashtu, të diskutojmë. Ne gjithmonë kemi dhënë pëlqime dhe pajtohëm me z.Laurat K. se nëse nuk e kemi në rend dite këtë pikë po ia marrim të drejtën paarshtuesit të Kërkesës dhe, nëse nështë në pyetje PN “Sharri”, ata vetë do t’a pengojnë Pëlqimin.

z.Arjeta Skeraj- Në mandatet e kaluara, asnjë herë, nuk kemi hequr nga rendi i ditës kërkesa të këtilla. Do të ishte më së miri të kalohet në miratim të rendit të ditës dhe të diskutohet në kuadër të pikës së rendit të ditës.

z.Naser Myrtezani- Ne si parti politike (LDK) e përkrahim këtë Kërkesë, sidomos tani ku parashtruesi i saj ashtë nga komuniteti jo shumicë. Ne mendojmë se, secili investim, që vjen e që zvogëlon papunësinë dhe punon për zhvillimin e Komunës, është e mirëseardhur.

Kryesuesi- Kalojmë në votim e rendit të ditës dhe kush është që, kjo pikë të jetë në rend dite? “Për”- 16, “kundër”-6 dhe 0 vota “të përmbajtura”, që konstatoj se pika e 3-të e rendit të ditës ngel në rend dite.

Pika e I-rë (parë) e rendit të ditës

Vazhdojmë me punën dhe, si zakonisht, fillimisht, kemi shqyrtimin dhe miratimin e Procesverbalit nga seanca e kaluar e Kuvendit, nëse ka vërejtje apo plotësime...?

z.Zaim Hajredini- Në fq.7 te rreshti i fundit, te numri 60 duhet të jetë 80, përkatësisht vitet e 80-ta.

Kryesuesi- Në rregull, nëse nuk kemi edhe diçka, e miratojmë Procesverbalin.

Pika e II-të (dytë) e rendit të ditës

Pra, vazhdojmë me pikën e II-të të radhës ku kemi shqyrtimin dhe miratimin Raportit të realizimit të buxhetit, për periudhën janar-shtator/2018 të cilin e keni pasur në material e që është praktikë ligjore e shqyrtimit të raporteve buxhetore për periudha periodike, të çdo viti kalendarik, për t’u konstatuar të hyrat dhe të dalurat buxhetore. Fillimisht, fjalën e ka kyretari i Komunës z.Shaban Shabani, urdhëroni z.kryetar...

Kryetari- “Bazuar në nenin 58 pika J të Ligjit 03-l/40 mbi vetëqveriasjen Lokale (“Gazeta Zyrtare” e Republikës së Kosovës nr.20/2008 të dt.04.06.2008) dhe nenin 45.4 të Ligjit 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi (“Gazeta Zyrtare” e Republikës së Kosovës nr.27/2008 të dt.03.06.2008) paraqes një përmbledhje të shkurtër të Raportit 9-mujor financiar, për realizimin e buxhetit Janar-Shtator/2018. Raportet financiare tregojnë inoformacionet lidhur me buxhetin, rrjedhën e parasë së gatshme, të hyrat, pagat, shpenzimet për mallëra e shërbime, shërbimet komunale, subvencionet dhe transferet dhe shpenzimet e investimeve kapitaler. Ky Raport Financiar prezanton të hyrat dhe shpenzimet e muajëve Janar-Shtator/2018 dhe bënë krahasime me muajt e njetë të dy viteve paraprake. Buxheti për vitin 2018 është miratuar në Kuvend, në shumën prej 8.069.990,00 euro, pas bartjes sëtë Hyrave Vetanake të pa shpenzuara në vitin 2017 në shumën prej 637.935,10 euro dhe të hyrave nga Fondi i Donatorëve të vitit paarak në shumë prej 13.028,65 euro, borgji komunal, në periudhën raportuese, arrin shumën 8.720.923,75 euro. Buxheti komunal, në këtë periudhë raportuese, është shpenzuar në shumën 4.801.540,19 euro dhe, në krahasim me periudhën e njetë të vitit paraprak, është shpenzuar në shumë prej 20,49%, ndërsa buxheti Janar-Shtator është shpenzuar në total 55%.

Pagat dhe shtesat-janë më të larta, në krahasim me priudhën raportuese të vitit paraprak, për arsye të rritjes së pagave prej 4% dhe rritjes së përvojës së punës. Shpenzimet për mallëra e shërbime-janë më të larta për 35,78%, në krahasim me periudhën e njejtë të vitit paraprak. Kjo tregon një formë më të mirë të shfrytëzimit të buxhetit. Shpenzimet komunale- janë më të larta për 13,43%, në krahasim me periudhën raportuese të vitit paraprak. Në këtë rritje ka ndikuar impianti për pastrimin e ujërave të zeza në fshatin Kapre. Subvencionet e transferet- janë më të ulëta për 6,63%, në krahasim me periudhën e njejtë raportuese të vitit të kaluar, për shkak se vitin e kaluar, subvencionet kanë qenë më të larta për 9,782 euro ose 28,22%. Në këtë vit, janë bërë më shumë pagesa për përfituesit individual, për shkak të disa rasteve emergjente ë janë paraqitur në Komunën tonë. Shpenzimet për investime kapitale-në krahasim me periudhën e njejtë të vitit paraprak janë më të larta për 143,41%. Në këtë kohë të raportimit të shpenzimeve, investimet kapitale janë në fazën përfundimtare të punimeve. Deri më tani janë përfunduar 25 kontrata dhe 43 projekte janë në procedurë të tenderimit. Të hyrat vetanake-janë më të ulëta për 10,67%, në krahasim me periudhën e njejtë të vitit kaluar. Në tabelë shifet se çertifikatat e lindjes, vdekjes, kurorëzimit, nuk janë në nivel të pritshëm, por programi këto i regjistron si taksa tjera të ofiçarisë. Të hyrat janë më të ulëta se vitin e kaluar, sepse në emër të borgjitt të Tatimit në Pronë, është bërë pagesa prej 40 mijë eurove nga ndërmarrja “Remateks”.

z.Laurat Krasniqi- Kur flasim për këtë Raport buxhetor, vërtjta ime themelore është se Komunën po e përcill praktika e përhershme, që mjetet po këthehen në suficit. Kjo po ngjan edhe këtë vit, duke pasur parasysh se buxheti aktualisht është realizuar për 55% dhe ka shansa që, mjete të mëdha, të shkojnë prap në suficit, pasi se edhe jemi mjedis maloro-kodrinor. Kështu, projektet që momentalisht po realizohen, për shkak të kohëzgjatjes së shkurtër të sezonit, kanë shansa minimale që të realizohen, deri në fund. Kemi edhe rënia drastike të të hyrave vetanake në emër të liçencave ndërtimore. Në tabelë shifet se dallimi në mes të vitit 2017, kur kishte 7 mijë euro, në vitin 2018 kemi 200,00 euro e që është dallim i madh. Po ashtu, po theksoj se DEkonomisë nuk i ka përfill rekomandimet e Auditorit, nga se të hyrat nga vendimet gjyqësore janë kyçur në emër të të të hyrave vetanake. Po ashtu, kemi edhe dallime në Raportin e Auditorit dhe të DFinancave dhe, me sa e dijmë, Auditori shënimet e merr nga Komuna, sepse kështu nuk po na përputhen raportet dhe, faktikisht, komuna e ka bërë vlerësimin e gabuar të hyrave?

z.Naser Myrtezani- Ne, si parti politike (LDK), kemi vërjetjet tona lidhur me mallërat e shërbimet te nr.4 reth telefonisë mobile që janë shpenzime afro 16 mijë euro që janë të larta dhe sa veta marrin mbushje telefonike? Edhe shpenzimet e karburanteve janë absurde e që janë afro 40 mijë euro, avansi për para të gatshme 2.500,00 euro, sigurimi i automjeteve 1.900,00 euro, taksa komunale 84,00 euro dhe mirëmbajtja 16 mijë euro, që del se shpenzimet ditore të automjeteve të jenë 202,00 euro, nëse ndahen për 185 ditë pune. Nëse marrim mesataren prej 10 litrave në 100 km. del 20 mijë km. rrugë që mjeton për t'u “shkuar në Hënë”?! Ndërkaq, te shpenzimet ditore për mirëmbajtje, sigirim dhe servisim hargjohen edhe plus 66 mijë euro, që nëse i ndajm në 190 ditë pune shpenzimet ditore janë 336,00 euro. Që të jemi më saktë, 9 muaj herë 22 ditë është 190 ditë, që për një muaj dalin 7 mijë euro shpenzime, kurse shifra përfundimtare del 66 mijë euro. Po ashtu, kemi vërejtjet dhe dyshimet tona te kategoria e reklamave në radio, gazeta dhe për konkurse-2.300,00 euro dhe, nëse këto kanë qenë, të na jepen detaje? Te fq.7 shpenzimet për investime kapitale, tek objektet arsimore-96 mijë euro dhe na thoni se për cilat objekte është fjala e që ne nuk kemi parë asgjë nga ato meremetime? Te ndërtimi i rrugëve-659 mijë euro

janë shumë e madhe e punët askund në terren, pos për në disa fshatra e që del se me këto mjete ka mundur të ndërtohet autostradë?! Edhe për kanalizime- reth 100 mijë euro, të jepen sqarime se psh.në Zaplluxhe nga 20 mijë janë shpenzuar 17.300,00 euro e punët e kryera janë katastrofale dhe askush nuk i ka mbikçyrë? Edhe te pasijet tjera-14.500,00 euro, për çka është fjala e shifra është e madhe, apo mos është paushale dhe është absurde që të hargjohen aq mjete?!

z.Valon Shabani- Siç theksoi edhe kryetari, pëderi sa opozita të jetë e fuqishme, edhe ne jemi të fuqishëm. Sa i përket Raportit të Auditorit, ne kemi hartuar Planin e Veprimit për realizimin e rekomandimeve. Në bazë të Raportit që e kem marr nga zyrtari i të hyrave, shifrat janë të sakta dhe mund të japim përshtypje detal të të gjitha të hyrave. Nga shuma e inkasuar, 30% i rikthehen Komunës e ai Raport ka qenë i vitit 2017 e tani jemi në vitin 2018 e ne po flasim kundër këtij Raporti dhe kur të përgatisim Raportin tjetër, ai në vëdi do të ketë edhe rekomandimet se sa ka pasur të drejt ish-drejtori, që të jap sqarime në vazhdim. Deri në vitin 2017 të hyrat janë llogaritur si të Komunës, që këtë e kanë bërë shumica e komunave dhe AKK i ka parashtruar Kërkesë MPBrendshme që të hyrat nga dënimet i takojnë komunave dhe ne, edhe më 2018, do të respektojmë rekomandimet e Auditorit dhe kam biseduar me Auditorin për këtë çështje. Kur jemi te pyetja e delegatit të “Vetëvendosjes” do t’ a kisha lutur, që kur të kritikon, këtë t’ a bënë pa paragjykim e ofendime në rrjetet sociale. Për këtë kam mjaft shembuj, siç është pagasa në emër të personave të vdekur, edhe pse delegatët e dijnë për ato pagesa. Ai ka folur edhe për rekomandimet e zyrtarëve dhe nga Raporti mund të shifni se asnjë cent nuk është shpenzuar jasht dispozitave ligjore. Te shpenzimet e telefonisë mobile, këto janë shpenzime për kartela mbushse që shfrytëzohen nga kryetari, nënkryetarët, drejtorët, shefat e shtabëve dhe ju delegatët dhe, nëse ju miratoni Vendim tjetër, kjo mund të ndryshoj dhe ndërpritet. Te shpenzimet për karburante të automjeteve, pajtohem se ato janë të larta, por duhet pasur parasysh se në këtë shumë-17 mijë euro janë shpenzime të mbetura, ndërsa shpenzimet, më së shumti, janë bërë për nevojat e administratës komunale për pjesëmarrje të ndryshme në seminare-trajnime dhe obligimet ditore të zyrtarëve. Pastaj, këtu janë shpenzimet për transportim e të smurëve me daliza, për transportin e klubeve sportive, praktikantëve për kurse në Prizren, vizita të shkollave, OVL-së etj. Sa i përket avansit me para të gatshme, të gjithë drejtorët e kanë të drejtën në shumë prej 50,00 eurove, për furnizime të imëta. Shpenzimet e reklamës janë shpenzime që i ka bërë Komuna me rastin e lajmërimeve në mjetet e informimit për: konkurse, reklama, njoftime etj. Te shpenzimet kapitale, ne e bëjm Raportin Vjetor, për ato i bëjmë- si tërësi.

z.Velid Haxhisin- Ky Raport përmban në vëdi më shumë fakte pozitive se sa negative. Më gëzon fakti se shkalla e realizimit të investimeve kapitale është shtuar, krahasuar me vitin e kaluar. Ajo që brengos është shkalla e ulët e realizimit të tatimit në pronë, brenda 2 viteve të fundit. Ne e dijmë se borgjlinjë të mëdhejnë ndaj komunës janë ata që kanë para e që kanë përfituar, kryesisht, nga procesi i privatizimit e që nuk është rasti me ata që mezi arrijnë fundin e muajit. Po ashtu, duhet anashkaluar debatet përmes rrjeteve sociale, kur e kemi web-faqen zyrtare të Komunës.

z.Samidin Xheladini- Ne, si delagatë, jemi organ mbështetës i pushtetit dhe me mundësitë tonë e japim kontributin, që pushteti mos të gabon. Në këdo të Raportit na paraqiten edhe tabelat nga të cilat disa na përgjigjen e disa jo, e mua nuk më pëlqen ajo që theksoi kryetari se se janë realizuar 25 kontrata

e 40 të tjera janë në proces, e që u përkasin investimeve kapitale e ne, si Komunë, jemi veçuar në mos realizimin e investimeve kapitale. Të shpresojmë se, këtë vit, do të jetë ndryshe e ne duhet të jemi të interesuar që realizimi i projekteve të jetë 100%, si dhe të kërkojmë edhe donatorë. Në bazë të Raportit i cili është i sakt dhe real, shifet se të hyrat vetanake janë më të ulta për 38% e kjo është mjerim, ndërsa te shpenzimet për mallëra e shërbime kemi shtime enorme e këtu do të përmendi shërbimet kontraktuese që janë 198% më të larta, apo 68 mijë euro, dhe kërkoj sqarim? Po ashtu, edhe kategoria për ushqim e pije është 259% më e lartë, krahasuar me vitin paraprak, kurse te nafta për nxemje qendrore kemi zvogëlim dhe parashtrohet pyetja se a janë furnizuar në Komunë me material për ngrohje? Gjithashtu, kërkoj sqarim se çka nënkuptohet me “mirmbajtje rutinore”, si dhe prap, po i potencoj shpenzimet e vendimeve të gjykatave që janë 7.678,00 euro, apo 3 herë më të mëdha se në vitin paraprak. Bie në sy edhe ndërtimi i ujësjellësit qendror, e do të ishte mirë t’ a dijnë të gjithë se kemi mungesë të ujit të pijes dhe të angazhohemi maksimalisht, që mjetet mos të na shkojnë në suficit. Nëse është e mundur të na sqarohet edhe kodi i transferit të kapitalit për entitete publike e jo publike, si dhe po theksoj atë se të gjithë dëshirojmë që, Auditori Gjeneral, të has gjendje sa më të mirë, me sa më pak vërejtje e në kuadër të rekomandimeve të Auditorit-te pika 7 kemi asfaltimin e rrugës për në Strezimir dhe pyes se çka është ndërmarr lidhur me këtë?

z.Zaim Hajredini- Do të fokusohem në 2 çështje e të gjithë jemi të vetëdijshëm se, vitin e kluar, kemi pasur mjaft mjete që na kanë shkuar në suficit, kurse, këtë vit, pushteti komunal është më azhur edhe duke i falënderuar opozitës e cila është më azhure dhe po je kontributin e vetë. Ne jemi të vetëdijshëm se është e pamundur që, disa mjete, mos të shkojnë në suficit, por që ato të janë minimale. Lidhur me ujësjellësin qendror, kërkoj që kjo çështje të zgjidhet sa më parë, pasi se qytetarët po ballafaqohen me probleme të mëdha, edhe pse dihet se çështja ka ngel tek pushteti qendror e jo te ai lokal. Nëse është e mundur, të ndryshohet e tërë procedura lidhur me këtë çështje dhe ne jemi të gatshëm të ndihëmojmë. Te të hyrat vetanake është brengosëse se pse pushteti lokal nuk ka grumbulluar mjaft mjete nga kjo kategori dhe, pajtohem me parafalësin, se nuk mund t’i kompenzojmë të hyrat vetanake, nga dënimet.

z.Nexhat Isufi-Te fq.5-tabela 4 te regjistrimi i automjeteve, a është ndërruar vendi, pasi se nuk e dij se sigurimi i automjeteve kushton më shtrenjët se regjistrimi? Pyeteje për kompetentët se a ekziston mundësia, për ngelje të një shume mjeteve nga ndonjë projekt që është realizuar, që ato mjete të riorjetohen, apo t’i parashohim me tender të rinjë e, që mjetet, mos të na shkojnë në suficit? Në këtë mënyrë do të jemi më efikas, kurse qytetarët do të janë të kënaqur.

z.Valon Shabani (DDEF-ca)- Me rastin e hartimit të këtij Raporti e kemi shfrytëzuar sistemin e organizuar të financave. Te ekzekutimi i vendimeve gjyqësore shifet se i kemi paguar shpenzime te projektit për hapjen e rrugës kah Shishtavec në vlerë prej 4.500,00 euro, 2 mijë euro janë në emër të pagesës së përmbaruesit privat dhe është një pagesë për lëndën në gjykatë përdhe pagesën jubilarë të një shërbyesi civil e që ka shkuar përmes gjykatës. Te “mirmbajtja rutinore” janë cekur shpenzimet ditore e oborreve të shkollave dhe vendosja e kamerave e kjo ka qenë ajo që është dashur të intervenohet. Shuma më e madh është te kategoria “shërbimet tjera kontraktuese” dhe, siç e dini, ne kemi angazhuar punëtorë të caktuar për shërbime të posaçme, si psh.mirmbajtja dhe pastrimi rrugëve nga bora, pastaj

këtë vit mbi 25 punëtorë kanë dalur në pensione dhe u janë paguar nga 3 paga jubilarë, pagesa e shërbyesëve civil, me nga një pagë, vendosja e tendave për aktivitete kulturore, vaksinimi i qenëve endacak, pagesa e shpenzimeve të nxënësëve në takimet sportive në Austri, pastrimi i lumit në fshatin Brod, marëmetimi i urës në fshatin Bresanë, furnizimi me gypa për kanalizimin në Kuk dhe pagesa e borgjit në emër të ATK-së në vlerë prej 2.500,00 euro, e që pastaj kjo shumë është shtuar në 6.500,00 mijë euro që, me ndihmën e zyrtarit, e kemi gjetur faturën e vitit 2003 dhe borgjin e kemi zvogëluar në 2.500,00 euro. Te tatimi në pronë, shuma vërtetë brengos dhe se, 10 ditë para hartimit të këtij Raporti shuma e tatimit ka qenë 10 mijë euro më e lartë se ajo krahasuar me vitin paraprak. Dallimi është se në vitin e kaluar kemi pasur pagesën nga ana e “Remateksit” e që, gjithsesi edhe këtë vit, nuk kemi qëndruar duarkryeq dhe se, në bazë të premtimeve, edhe këtë vit, do të ketë pagesa.

Kryetari- Duke pasur parasysh se, këtë vit, kemi pasur amnestime të borgjeve e që në bazë të tyre ka ngjarë që disa firma kanë paguar borgjet e tyre, duke e shfrytëzuar atë të drejtë e që do të thotë se kemi dallime të mëdha në tenderin e grumbullimit të të mjetëve vetanake për tatim në pronë. Nëse krahasojmë grumbullimin e mjetëve, në emër të timit në pronë, para vitit të kaluar me këtë vit, do të shifet se jemi në shkallën e përafërtë. Sa i përket Raportit të Auditorit Gjeneral, është e pamundur që të bëhen kontrolimet e të gjith institucioneve e mos të gjenden gabime e kjo, në Kosovë, është e pamundur, siç është e pamundur edhe në shtet tjera më të zhvilluara botërore, pasi se auditorët gjejnë lëshime dhe japin romandimet e tyre. Ne tentojmë që, brenda mundësive tona, të përmirësojmë situatën në institucionet tona. Sa i përket çështjes së hapjes së rrugës për në Strezimir, mund të them se ai Projekt ka përfunduar, pasi se ka qenë projekt i finansuar me palën e tretë. Sa u përket investimeve kapitale, siç theksuat ju, nuk mund të jemi të kënaqur me gjendjen ekzistuese, pasi se mund të punohet më mirë, por që krahasuar me vitin paraprak, mendoj se jemi të suksesshëm, pasi se në pyetje është Raporti 9-mujor e që llogarim mjaft në interevalin e mbetur kohor e që do të kemi pasqyrimin e qartë me Raportin Vjetor Financiar e ku do të vlerësohet edhe shkallat e realizimit të projekteve e që llogarisim se ajo do të jetë më e mirë.

Kryesuesi- Kalojmë në votim të Roportit 9-mujor buxhetor dhe kush është “për”-16, “kundëer”-7 dhe 1 votë “e pmbajtur”, që konstatoj se emiratuaam këtë Raport Buxhetor 9-mujor/2018.

Pika e III-të (tretë) e rendit të ditës

Kryesuesi- Kalojmë në pikën e III-të radhës lidhur me Kërkesën e SH.P.K. “Sharr Pllania Vode”- Dragash për ndërtimin e mini-hidocentraleve në ZK Brod, hapim diskutimet...

z.Zinaida Elmazi- Meqenëse kemi pasur kërkesa që na i kanë përcjellur për në Kuvend-investuesit, kërkoj që personi i cili e ka prashtruar këtë Kërkesë të vjen këtu në Kuvend, që të na prezenton atë. Ne këtu kemi diçka, që unë nuk e kuptoj se cilat kuota janë dhe këtë do të kërkoja nga investuesi, që të fillohet me diskutimet. Nëse më herët, kolegët e tij, kanë paraqitur kërkesa dhe kanë qenë prezent këtu, duke e bërë edhe prezentimin, këtë ka mundur t’a bënë edhe ai? Prandaj, nuk e di se si ai ka mundur të privilegohet dhe, pa prezantim, të merr Pëlqimin, nga ne?

z.Rexhep Kamberi- Para fillimit të prezantimit, më duhet të shprehi keqardhjen se pse nuk është pranuar sugjerimi i Kkomunitete, që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës? Unë, këtë Kërkesë e kuptoj jo serioze. Në Kërkesën për këtë investim fjala është për investim të madh, dokumentacioni i cili na është paraqitur duhet të jetë më i gjerë, detal e ne këtu e kemi emrin e parashtruesit të Kërkesës, numrin e parcelës për Pëlqim dhe dëshirën e tij dhe asgjë tjetër? Nuk e kemi arsyeshmerinë ekonomike, njohurinë se cili do të jetë kapacitetit e centralit, vlerën e investimeve, sa punëtorë do të punësohen e shumçka tjetër. Për këtë, këtë Kërkesë e trajtoj jo serioze dhe nuk do të duhet të ishte në rend dite Në bisedë me personat e lëmisë së gjeodezisë kam kuptuar se kuotat gjenden në kufijt e PN “Sharri”, dhe ne këtu jemi në pozicion të deklarohemi, ka apo s’ka shkelje ligjore e fjala është për pjesën nën mbrojtje të shtetit?! Për këtë, dëshiroj t’u apostrofoj udhëheqësisë komunale se turizmi është degë e cila më së shumti i kontribuon zhvillimit të Komunës sonë. Me dhënien e Pëlqimit për ndërtim të HC-ve në këtë pjesë, ne po i dëbojmë investuesit që do të investonin në turizëm e lere më të flitet për problemet reth ujit të pijes e cila pjesë, atje lartë, është më e shëndetshmeja e që, dita-ditës, është në deficit dhe për këtë e di se kjo Kërkesë duhet të refuzohet dhe, edhe një herë, e lus Kuvendin me organet komunale dhe delegatët, që të marrin parasysh qëndrimet e Kkomunitete, pasi se komuniteti jo shumicë, përmes këtij Komiteti e shef sigurinë e vetë.

z.Velid Haxhisin- Siç po e shihni, nuk ekziston ironi më e madhe se sa të debatoteh për mini HC-të dhe t’i dëgjojmë gjeneratorët! Ne, si Komunë, i kemi shfrytëzuar të gjithë kapacitetet për ndërtimin e mini HC-ve të territorit tonë e madje mendoj se i kemi tepruar e tejkaluar me shfrytëzimet e hidropotencialeve. Pë këtë, unë nuk do t’a analizoj këtë Kërkesë në pjesën ku theksohet “kërkojmë me partnerin tonë lidhur me investimet tona” e ne këtu nuk po i analizojmë barazimet “x” e “y”, por ne po o zgjidhim barazimet me akterë të njohur?! Natyrisht, duke mo ia kontestuar asnjë investuesi të drejtën për të investuar e, pikërisht këta segment të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuara si “Shaerr Pllanina Vode”, janë planifikuar edhe me projektet e “Eurokosit” e ne kemi bërë presione kur ka qenë e pamundur nga ndërtimi i tyre e që, s’paku, ata të largohen nga projekti i tërësishtëm? Fjala ka qenë për këta segment të përmendur në pjesën mbi fshatin Restelicë. Mendoj se në këtë mënyrë ne do të kontestojmë të drejtën për investime në turizëm dhe blegëtori. Po ashtu, mendoj se me këtë Projekt komuan e jonë nuk do të përfiton shumë, por do të humb shumë e në këtë ujat i sigurt. Më vjen mirë se, dikush nga komuniteti ynë është paraqitur me investime, por ky investim i tejkalon të gjithë kufijt e mundshëm, pasi se gjendet në pjesën ku njerëzit normal kurr nuk do të ndërtonin mini HC.

z.Munir Jonuzi- Me miratimin e Ligjit për PN “Sharri” në vitin 2013 nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës, me kufijt e atij Parku dhe caktimin e zonave të tij, të ndara në 3 zona, e nga vetë Kërkeasa shifet se ndërtimi i tyre duhet të bëhet në zonat 1 dhe 2 e që është edhe më keqë 90% nga një mini HC do të jetë në zonën e 1. Me miratimin e Kërkesës së këtill, ne si Kuvend, po i shkelimim ligjet dhe po e shkatërrojmë natyrën dhe, kur flasim për shkatërrimin natyrës, po e shfrytëzoj rastin që të theksoj se, me shqyrtimin dhe miratimin eventual të kësaj Kërkesë, po e cenojmë edhe një ligj tjetër e ai është Ligji për Mbrojtjen e Natyrës i cili, në mënyrë detale, rregullon mënyrën se kush e jep Pëlqimin, kur është në pyetje PNacional. Meqenëse Kërkesa përmend koncesionin, ai Ligj e rregullon edhe koncesionin dhe atë me nenin 135 A dhe nenin 136 ku thuhet se koncesioni nuk mund të jepet në kufijt 1 dhe 3 të PN e, pak më parë, theksova se planifikimi parashihet në zonat 1 dhe 2. PN ka vlerë shkencore, kulturore,

edukative, arasimore dhe rekreative dhe në PN është e ndaluar shfrytëzimi i të mirave natyrore. Meqenëse parashtruesi i Kërkesës është i komunitetit jo shumicë, disa nga ne e njohin atë person dhe, është për çudi, se si ai person u cili ka qenë në situatë të vështirë financiare, deri në vitin e kaluar, tani, menjëherë, paska mjete për ndërtimin e mini HC-së?! Të nderuar kolegë dhe kolege, ne jemi të zgjedhurit e popullit dhe ai na ka dhënë mandatin që të punojmë sipas ligjeve dhe për këtë e kemi dhënë betimin se, në mënyrë strikte, do të repektojmë ligjet dhe intereset e qytetarëve të komunës së Dragashit. Edhe një herë po theksoj se me dhënien eventuale të Pëlqimit, pasojat do të janë të mëdha, për të gjithë ne. Kam dronë se kryetari dhe kryesuesi të parët do të përfundojnë në gjykatë dhe do të janë të paditur nga ana e PN dhe, për këtë, ju thërras që të votoni “kundër” këtij Pëlqimi?!

z.Hajrudin Hoxha- Unë pajtohem me parafolësit dhe kjo Kërkesë që e kemi sot në shqyrtim është jo e sinqertë, pasi se, pas saj, diçka po mshifet e ne nuk po e dijmë?! Por, ndoshta, disa e dijnë?! Na është ofruar që t'a votojmë, pasi se ai i cili e ka përgatitur këtë Kërkesë është dashur të bashkangjet edhe statistikën e afizimit, letërnjoftimin e kërkuesit, që të kishim njohuri. Unë, në ndërkohë, kam pasur diskutime me qytetarët e fshatit Brod dhe mund të them se do të jemi në situatë, siç kanë qenë banorët e Vraniçit e, ndoshta, edhe më keqë? Prandaj, meqenëse ky parashtrues i Kërkesës është nga Brodi, ka mundur të bashkangjet edhe pëlqimet-nënshkrimet e qytetarëve, në mënyrë që ne të kishim arsyetime, pasi se nëse nesër vjen deri tek konflikti me ta dhe policisë, dhe mos të jemi ne fajtor për atë se e kemi dhënë Pëlqimin. Për këtë, mendoj se kjo Kërkesë është jo serioze dhe se dikush po,luan me ne, në Kuvend? Pavarësisht se si kush do të voton, të ndihet përgjegjësia para qytetarëve, sepse faktikisht po ngjan se ne nuk jemi institucion serioz i cili respekton qytetarët. Mos të luajmë me disa gjëra, pasi se disa nga delegatët po dëshirojnë të përkrahin këtë e ne këtu jemi të gjithë të njëjtë, si nga komuniteti shumicë dhe ai jo shumicë, pasi se e përfaqësojmë popullin dhe, edhe një herë, po i lus delegatët që mos të përkrahin këtë Kërkesë dhe të votojnë “kundër”? Në të kundërtën, do të shkojmë në konflikt me qytetarët dhe PN “Sharri”.

z.Selman Osmani- Sa i përket parashtruesit të Kërkesës, i cili i përket komunitetit Goran, mendoj se shumica këtu, nga komuniteti jo shumicë, po merren me çështje të parëndësishme dhe po e karakterizojnë parashtruesin e Kërkesës si parson i cili ka apo s'ka mjete e ne nuk do të merremi me këtë, pse? Ndoshta, njeriu ka marr kredi, apo ka siguruan dnonjë dobnator? Duke a pasur parasysh se ai është nga Brodi, me siguri, e ka edhe Pëlqimine banorëve të Brodit dhe ne nuk mund të diskutojmë sipas paragjytimeve tona, pasi se ka dallim dhe pse ai, deri në vitin e kaluar nuk e ka kërkuar Pëlqimin për një projekt të këtillë? Po dëgjojmë se disa shumë po përkujdesen për PN “Sharri”, sikur të janë përfaqësues të atij Parku dhe, si duket, disa nga kolegët këtu, nuk po e dijnë definimin e PNacional e ai është vendstrehim i specieve të rrezikuara të kafshëve, dhe pse nuk keni votuar për nacionalizimine pyejeve?1 Atëherë, kur z.Naim Ramadani ka shkuar, nga fshati në fshat, dhe ka folur haptas, që mos të gabohet dhe mos lejoni nacionalizimin e pyejeve, shumë gjëra janë gabuar këtu dhe, ndoshta, kryetari ka jurista kompetent që do t'i sugjeronin se kjo është e jashtligjshme? Unë këtu po e shof se përfaqësuesit e komunitetit Boshnjak po hyjnë në mbrojtjen e komunitetit Goranë, që unë personalisht jam që t'i ndihëmohet këtij qytetari dhe, nëse kjo nuk ngjanë, me siguri, kryetari do të themelon një Komision e cila do të din që t'a menaxhon mirë pronën?

z.Granit Rifaj- Nga praktika e mëhershme, se edhe disa investues tjerë e kanë cenuar PN "Sharri", dhe se kanë marr Leje ngas PN për investimet e tyre. Nga ky diskutim po shohim se kemi mospajtime, pasi se unë mendoj se, dhënia e Pëlqimit nga Kuvendi, është hapi fillestar. Dikujt nuk po i pëlqen kjo e mua, po më vjen mirë që, pikrisht një pjestar i komunitetit jo shumicë po bënë Kërkesë për investime, pasi se, deri më tani, kemi pasur akuza se, vetëm Shqiptarët, po investojnë?! Ne, si GP i PDK-së, parimisht, e përkrahim këtë Kërkesë dhe se, çka do të vepron ai me PN dhe institucionet tjera, është çështje tije?

z.Zinaida Elmazi- Po theksoni se e ka edhe Lejen e fshatit, por ne këtu nuk e kemi dhe pse nuk ka reaguar PN "Sharri" dhe parashtrohet pyetja se a ka qenë fare në dijeni për këtë? Kjo Kërkesë nuk ka shkuar deri te PN i cili, me siguri, nu do të lejonte ndërtimin atje?

z.Sefidin Mejzini- Me befasojnë kolegët të cilët po shprehin kaq dyshime ndaj këtij personi i cili ka parashtruar Kërkesën dhe se me te nuk është biseduar, paraprakisht, që do të kishte edhe kushtëzime të caktuara e që, edhe për mua, krijon dyshim e këtu qëndron çështja kryesore. Ai, nuk po i jep llogari askujt, dhe Kërkesën e ka paraqitur te ne-në Kuvend? Ne, si LDK, jemi për investime dhe se a do të ketë pëlqime tjera nga institucionet përkatëse, mbetet të shihet. Se dijë, sepse ju jeni në koalicion dhe, kur të dëshironi, i krijoni 18 vota e që pra është në pyetje interesi i ngusht dhe, nëse Kërkesa nuk është në rregull, ka se kush t'ia pengoj procesin?

z.Nexhat Isufi- Qytetari ka bërë kërkesën e cila nuk i është adresuar Prizrenit apo Prishtinës, por neve dhe ne e kemi për obligim t'i japim përgjigje, e në mandatin tonë është që mos të cenojm ligjet dhe të japim pëlqime atje ku është territori ynë dhe të deklarohe mi, me ngritjene dorës, pasi se askush nuk mund të më bind se a është diçka mirë apo keqë, se a është Shqiptar apo Goran, pasi se unë përkrahi çdo qytetar i cili dëshiron të investion në komunën tonë. Unë nuk përkrahi asgjë, kur dëmtohet prona apo cenohen ligjet.

z.Laurat Krasniqi- Më herët, janë dhënë pëlqime, kur investuesit i kanë pasur pëlqimet e qytetarëve, e ne je të zgjedhurit e popullit dhe, në momentin kur japim pëlqime, ne ballafaqohemi edhe me revoltin e qytetarëve, si në Vraniç, dhe ne mund të takohemi me investuesin dhe banorët e fshatit Brod dhe të veprojmë, pastaj? Ne, po e vejmë në konflikt investuesin me qytetarët e Brodit, pasi se ne nuk mund të japim pronën e dikujt tjetër?!

z.Velid Haxhisin- Unë do të kisha kërkuar respektimin Rregullores së Punës së Kuvendit e ajo po repektohet pjesërisht, në momente të caktuara, e kur bëhet fjalë për çështje të ndieshme, praktika ka qenë se janë bërë tolerime, me marrjen e fjalës, nga disa herë, për t'u sqaruar gjërat. Dhe, nëse duhet biseduar për diçka, që dikujt nuk i konvenon, atëherë, menjëherë, respektohet Rregullorja?! Unë, edhe një herë, apeloj në delegatët se ne, për HC-të që janë ndërtuar deri tani, ato nuk kanë qenë në PN "Sharri" e ne tani po flasim për PN, dhe se po flasim për atë se çka përfitojmë nga HC-të si qytetarë të komunës sonë. Pasi se i përmenda zhurmat e gjeneratorëve, nën të cilën po e mbajmë edhe këtë seancë, gjithçka është e qartë dhe s'kemi se çka të flasim. Unë nuk ia kontestoj të drejtën e votës asnjë delegati, por këtu duhet të vendoset me argumente, që pastaj mos të ndeshemi me probleme e që ne nga komuniteti jo shumicë, sa më parë, t'i zgjidhim këto probleme. Mendoj se kjo që po ngjan nuk është në rregull nga

kolegët, pasi se këtu nuk bëhet fjalë vetëm për PN, por për shkatërrimin e natyrës dhe të veproujmë pozitivisht reth turizmit dhe bujësisë e blegëtorisë.

z.Rexhep Kamberi- Këtu nuk bëhet fjalë për atë se a është në pyetje Shqiptari i Gorani, por bëhet fjalë për Kërkesën që është jo serioze. Na kanë ardhur në shqyrtim kërkesa të ndryshme, si psh.z.Lirim Sadikaj etj. që kanë pasur dokumentacione përcjellëse e këtu është vendosur me një fjali, sikurse të them unë se po dëshiroj të ndërtoj HC e është mundur të thuhet po ndërtoj edhe aeroport e që ne të japim Pëlqim, pasi se ai po investojka?! Ndërsa, ajo se a ka investime nuk mund të paragjykojmë e kjo dëshmohet me dokumentacione shtesë dhe kjo mua nuk më ngjan si Kërkesë, por si letër Kuvendit?!

Kryesuesi- Në rregull, kalojmë në votim dhe kush është “për”-10, “kundër”-7 dhe 3 vota “të përmbytura”, që pra miratohet Kërkesa.

Pika e IV-të (katërtë) e rendit të ditës – “eventuale”...

Kryesuesi- Kalojmë në pikën e IV-të të radhës-“eventuale”, hapim diskutimet...

z.Naser Myrtezani- Një pyetje reth ujësjellësit qendror të Dragashit në kuadër të të cilit janë kyçur 15 fshatra, se kur do të fillohet me punimet, apo ai ngelet në mëshirën e kompanive punëkryese? Edhe një pyetje reth ujësjellësit qendror të Dragashit, në kuadër të të cilit janë kyçur 15 fshatra se kur do të fillohet me punimet, apo do të ngelet në mëshirën e kompanive punëkryese? E dyta, ka të bëjë me ndërprerjet e energjisë elektrike nga ana e KEK-ut, e që po ngjan shpesh dhe se a keni pasur kontakte me ata, nga se jemi parapagues të rregullt dhe kemi dëme të mëdha lidhur me këtë? E treta, a janë siguruar lëndët djegëse nëpër shkolla dhe a keni kontaktuar lidhur me këtë, se sa do të jet m/3 i druve dhe kur do të arrijnë ato, në tërësi nëpër shkolla? Po ashtu, në internet janë plasuar fotografite për punën që po kryhen në Bresanë lidhur me ujësjellësin e jemi dëshmitarë se si po punohet dhe pyes se a do të mbyllen ato gropa dhe a i monitoron dikush punimet atje? Lidhur me lidhëset atje a janë paraparë sipas Projektit, që vetë qytetarët t’i blëjnë ato që kanë kushtuar nga 17-22,00 euro për një dhe, nëse janë 500 lidhëse, nga 20,00 euro, kjo është 10 mijë euro?! Po ashtu, kërkesë qytetare, që sipas mundësive, të bisedoni me MInfrastrukturës që të vendoset linja e bardhë në rrugën Zaplluxhe-Bresanë-“Mejdan” dhe a keni ndarë mjete për mirëmbajtjen e rrugës Zaplluxhe-Lez-Prizren?

z.Sefidin Mejzini- Pasi se jam nge lëmia e arsimit, do të parashtroj një pyetje për kryetarin se, nga marrja e mandatit, në lëmin e arsimit janë hapur 3 konkurse për procesin të cilin e kam përcjellur personalisht dhe mund të them se, për atë, janë përdorur standarde të ndryshme dhe krijuar komplikime. Te konkursi i parë, kanë qenë standarde tjerë, te i dyti asgjë nuk është publikuar, e ka të bëjë me lajmërimin e atyre që kanë konkuruar lidhur me marrjen e poenave në testin në formë të shkruar, e që është shkelje, që duhet eliminuar. Ata kandidatët që e kanë dhënë testin, në formë të shkruar, janë ftuar me telefon e ata që nuk e kanë bërë, nuk janë ftuar dhe madje nuk janë njoftuar as të parët e as të dytën herë, për ponat e marr. Ndërkaq, në konkursin e tretë janë publikuar vetëm rezultatet apo poenat e marr në përqindje e asgjë tjetër?! Kaunditatët që kanë marr pjesë në konkurs dëshirojnë të dijnë, e kjo është e drejtë e tyre ligjore, që të dijnë se sa poena kanë marr në testin me shkrim dhe me gojë. Po ashtu, edhe një pyetje lidhur me Komisionin për Dhënien dhe Vlerësimin e e Pronës Komunale e që dua të thekoj se,

ne të cilët jemi në atë Komision-përfshi delegatët e Kuvendit, rregullisht vijmë në takime dhe, kur caktohen ato takime, ata që janë caktuar nga ju-Komuna e ata janë 4 veta, nuk marrin pjesë në takime?! Kjo është nënçmim e ofendim, për ne që vijmë nga fshatrat për reth e anëtarët nga Komuna nuk marrin pjesë?! Për këtë, pres që të ndërmerrni masa?

z.Rexhep Kamberi- Kam një pyetje për shërbimin përkatës e kjo ka të bëjë me atë se ka pasur një konflikt verbal në mes të fshatrave Kërstec e Rapçë, e qytetarët më kanë njoftuar se janë paraqitur tek shërbimet e Komunës, por nuk e dijnë të theksojnë se a u janë drejtuar juve apo ZLKKthimit? Meqenëse u janë drejtuar institucioneve, dëshiroj të di se për çka është fjala dhe se a ka ardhur te zgjidhja e çështjes së tyre?

z.Laurat Krasniqi- Kam një pyetje lidhur me drejtorin e QKMF-së, pasi se sipas Ligjit mbi Shëndetësishtë, drejtori i QKMF-së duhet të jetë specialist e kjo qëndron edhe në Statutin e tyre, ekziston mjeku i cili është në këtë funksion e është në përfundim të specializimit, por që nuk është ende specialist? Për këtë, kërkoj që të ndërmerrni masa?!

z.Arjeta Skeraj- Unë dëshiroj të pyes kryetarin e Komunës, pasi se jemi në prag të sezonit dimëror, se a janë bërë përgatitjet për sezonin dimëror?

Kryetari- Pyetje e cila më së shpeshti parashtrohet është ajo e ujësjellësit qëndror dhe është mirë që parashtrohet nën pikën "eventuale", që kemi njohuri reth saj. Nëse ekziston ndonjë çështje e ndieshme në Komunën tonë, gjatë këtyre viteve, është pikërisht kjo çështje e ujësjellësit qëndror. Dhe, është vërtetë se, për të 4-tën herë, po anulohet tenderi dhe kam informata se është filluar me procedurat e tenderimit, por që ato, kryesisht, janë lidhur me Projektin. Por, ju kisha lutur që të dini se Zyra e Prokurimit është gjithnjë e hapur për çasje e sqarime dhe mund të shfrytëzoni atë të drejtë. Kemi 4 operator ekonomik dhe, çdo herë, na është kërkuar vlerësimi i Projektit, nga fillimi. Mjerisht, Komisioni është i orjentuara në çmimin më të ulët gjatë tenderimit, por prap kemi pasur kërkesën për përsëritje të tenderit dhe presim zgjidhje të kësaj çështjeje-së shpejti? Unë, si kryetar aktual i Komunës, sikurse edhe ai para meje, e kemi dhënë maksimumin e angazhimit tonë, që kjo çështje të nisët nga fillimit. Por, duke pasur parasysh se Zyra e Prokurimit është organ i pavarur në veprime, mbetet të shifet se çka më tej? Për këtë janë të lajmëruara instancat më të larta kompetente. Fatmirësisht, për këtë vit, për këtë çështje, kemi mjete të parapara nga kategoria e të hyrave vbetanake e që, nëse prap dëshron Projekti, mjetet mund t'i shfrytëzojmë në vitin tjetër. Ndërkaq, dallimi në mes të operatorit të parë e të dytë është 500 mijë euro dhe mund të them se nuk jemi pasivist reth kësaj çështjeje. Ne jemi të obliguar t'i ndjekim procedurat ligjore e këtu mund të interesoheni edhe ju si anëtar të Kuvendit, kurse unë madje kam kërkuar që procedura reth këtij ujësjellësi të anulohet e të fillohet nga e para. Nuk është logjike që 15 fshatra të ngelin pa ujë të pijes, për shkak të procedurave të caktuara. Mund të them lirisht se, asnjë herë, nuk ka pasur kompani të posaçme të përzgjedhur. Çështje tjetër ishte çështja reth ndërprerjes së energjisë elektrike e kjo është aktuale kohëve të fundit dhe ne, sidomos gjatë qëndrimit të bashkatdhetarëve tonë në vendlindje, kemi ndërmarr masa që çështja të qëndron më stabile dhe kompania furnizuese ka plane në kuadër të përmirësimit të gjendjes dhe atë plan kanë filluar t'a realizojnë gjatë sezonit veror kur është organizimi i ahengjeve familjare te ne e jemi marr vesh që këtë t'a

përfundojnë pas sezonit veror, si dhe ndërprerjet të janë në intervale të shkurtëra. Sa u përket sigurimit të lëndëve djegëse nëpër shkolla, ka qenë gjendje shqetësuese e kemi pasur vërtje nga drejtorit dhe prindërit. Por, duke i falënderuar kohës së volitshme që mbretëroi gjatë këtij sezoni, kemi arritur të rregullojmë gjendjen me procedurat, që kanë filluar qysh në muajin qershor. Por, duke pasur parasysh edhe vendimin e MASHT-it, që nga shkollat të braktiset nxemja me thëngjill, gjandja u vështirësua e me këtë problematikë nuk ballafaqohet vetëm komuna jonë. Ne, për këtë, kemi kërkuar përjashtim për komunën tonë nga ministritë që të merren parasysh kushtet dhe rethanat tona mbidetare e klimatike, pasi se Restelica jonë nuk mund të krahasohet me Fushë Kosovën Sidoqoft, ne kemi arritur pajtueshmerin me operatorin furnizues që të furnizohemi për 53,00 euro për 1 m³ dru. Sa u përket projektit në fshatin Bresanën, nga jam edhe unë, e di se si po realizohet dhe sa i përket kalimit të rrjetit të ujësjellësit atje, ai duhet të kalon ku ka qenë edhe më parë, por jam i vetëdisjshëm se projektet e caktuara nuk po na kryhen, siç po dëshirojmë. Kemi vërejtje edhe tek punëkryesi i punimeve dhe mbikçyrësi i tyre, por do të shofim se si do të përfundohet? Sa u përket lidhësive atje, për çka ka qenë vështirë të parashikohet se sa duhen, familjet e kanë marrë përgjegjësin mbi vedi. Sa i përket shënimit të rrugëve me linjë të bardhë, ajo është duke ndodhur në kuadër të mirëmbajtjes së rrugëve, por që po ngjan që të shlyhet ngjyra. Kurse kompania mirëmbajtëse e ka obligimin e tillë për 3 vite dhe , përmes saj, çështja do të zgjidhet. Po ashtu, jeni në dijeni se, ne si komunë, kemi ndarë mjete për mirëmbajtjen verore e dimërore të rrugëve lokale dhe sivjet, sipas praktikave pozitive, për sezonin dimëror parashohim të angazhojmë kompani private mirëmbajtëse të rrugëve. Sa u përket procedurave reth konkurseve, mund të them se ekzistojnë procedurat ligjore dhe administrative e që duhet respektuar dhe do të interesohem personalisht për disa pargullsi procedura që u apostrofuan këtu. Sa i përket Komisionit për Vlersëim të Pasurësë, kjo çështje më brengos edhe mua, pasi se nuk qenkan kyçur në takime zyrtarët komunal, edhe pse jam në dijeni se disa nga ata kanë qenë të ngarkuar me punë të rregullta zyrtare. Nëse kjo vazhdon, në të ardhmen, mund të llogaritet edhe në ndërrimin e tyre me zyrtar tjer. Sa u përket kontakteve të banorëve të Kërstecit dhe të Rapçës, siç e dini, ne vitin e kaluar, e kemi miratuar një Projekt për ndërtimin e ujësjellësit për banorët e Rapçës së Poshtme, por që kur kanë filluar punimet, janë ankuar banorët e fshatit Kërstec dhe kanë kërkuar ndërprerjen e punimeve, duke kontestuar burimin e ujit?! Siç jemi informuar, ky ka qenë problem i kahmotshëm i tyre lishur me burimin e ujit. Për këtë është dashur të angazhohemi si udhëheqësi komunal, duke u përfshi edhe ZLKomunitëve dhe Këthimit e që, deri tani, nuk kanë dhënë sukses bisedimet dhe punimet, mjerisht, jemi detyruar t'i ndërpresim?! Unë jam munduar për zgjidhjen më të mirë të mundshme, që mos të vjen deri tek konflikti në mes të banorëve të këtyre dy fshatrave. Sa i përket çështje së drejtorit të QKMF-së dhe kërkesë që drejtori të jetë mjek-specialist, e kemi miratuar Statutin e saj më herët e, në ndërkohë, ka ardhur deri tek ndryshimet e që drejtori duhet të jetë specialist dhe jemi në pritje të Pëlqimit nga MShëndetësisë. Sa u përket mirëmbajtjes dimërore të rrugëve lokale, jemi në procedurë dhe se operatori do të merr obligimet e pastrimit të tyre, siç merreen obligime përmes tenderimit.

Kryesuesi- Në rregull, nëse nuk kemi edhe diçka, me këtë përfundojmë seancën e sotme.

E përgatiti :

Shërbimi i Kuvendit Komunal

K r y e s u e s i :

Betim Merdiu

z

